



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 903 prot.

Fushë-Arrëz, më 26. 03. 2025

PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 26. 03. 2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Besjana Marku; Franc Doda; Mustaf Pashkaj; Pavlin Qafa; Tereze Dema; Valentina Lleshaj; Valentin Doçi; Vjollca Tabakaj.**

( 9 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë Kryetari i bashkisë, **Z. Hil Curri**

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Mars 2025! Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen (9 këshilltarë) e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes.

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Shkurt 2025.
2. Projektvendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025, në territorin administrativ të bashkisë Fushë-Arrëz.
3. Projektvendim për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz.
4. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.
5. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.
6. Të ndryshme.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës përmes votimit:

➤ Miratohet rendi i ditës me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës:

**9 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 1 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Shkurt 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

**Klotilda Curri**, Përfaqësuese e Zyrës së Emigracionit e Çështjeve Sociale, shpjegon se për muajin Shkurt 2025 kemi propozuar për ndihme ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 31 familje, me fond 126,825 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 2,113,755 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën 122,451 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 15 familje me fond 52,401 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .
3. Njësia Blerim , 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Fierzë , 4 familje me fond 21,602 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .

Shtohen në bllok-ndihmën e 6% familjet:

1. Dallendyshe Mhill Ndreca ( Fierzë ) Kryefamiljare e ve me tre fëmijë .
2. Mentor Praela ( Fierzë) Familje në vështirësi .

Largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja:

1. Dava Marku ( Qendër ), për riaplikim në Ndhimën Ekonomike .
2. Kristjana Fratell Kola ( Qendër ), ndodhet jashtë vendi.
3. Sadri Dervishaj ( Blerim ), penalizuar nga sistemi për mosdeklarim pensioni.

**Franc Doda**, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale, shprehet se komisioni janë dakord me propozimet e Zyrës së Çështjeve Sociale për familjet që përfitojnë 6% të bllok-ndihmës ekonomike sipas listave të sjella.

Njëkohësisht, **Franc Doda**, si anëtar i komisionit të Mirëqenies Sociale ka kërkesë që në mbledhjen e ardhshme të komisionit të jenë prezent Specialistët e Ndhimës Ekonomike të të gjitha Njësive Administrative për të shpjeguar me detaje lidhur me përfituesit e 6 % të Ndhimës Ekonomike, kërkesë të cilën e ka bërë edhe në mbledhjen e Komisionit të mbledhur me datë 25.03.2025.

Bashkia Fushë-Arrëz i ka sjellë dhe shpjeguar të gjithë ato që i nxjerr sistemi nga Ndhima Ekonomike për pikë të pamjaftueshme, ndërsa Njësitë Administrative jo, prandaj po i thërrasim të qartësohemi.

**Vjollca Tabakaj**, anëtare e këshillit të bashkisë:

Sot duke ardhë rrugës për në mbledhje, takova një banorë të fshatit Kokdodë, Fierzë, quhej Vogël Zef Biba i cili tha që nuk kam askënd në punë dhe se po shkoj të ankojem në bashki se nuk merrte Ndihmën Ekonomike.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Aplikimi bëhet këtu apo në Njësitë Administrative?

**Klotilda Curri**, Përfaqësuese e Zyrës së Emigracionit e Çeshtjeve Sociale: Aplikimet bëhen pranë çdo Njësie Administrative. Personi në fjalë ka ardhë sot këtu, është çeshtje afatesh kohore ligjore. Duke u bazuar në ligjin përkatës ne jemi në pritje të një përgjigje nga Zyrat përkatëse në Shkodër. Të gjithë personat që aplikojnë për Ndihmë ekonomike dhe i nxjerr sistemi për pikë të pamjaftueshme, përfitojnë masën 6% të shpërblimit.

**Hil Curri**, Kryetar i bashkisë:

Punonjësit e kësaj fushe janë të lidhur zingjirë në punën që bëjnë. Përveç punonjësve social që ofrojnë ndihmë banorëve kemi edhe këshilltarët dhe kryepelqtë nëpër zona të cilët duhet të interesohen për nevojat e banorëve gjithmonë duke iu referuar kritereve të përfitimit në bazë të ligjit përkatës. Banorët e kanë të vështirë të aplikojnë vetë, prandaj janë punonjësit. Unë kam vënë theksin për një Qeverisje pranë qytetarëve, prandaj të gjithë punonjësit duhet të angazhohen maksimalisht për t'ju ardhë në ndihmë banorëve.

Unë kam bërë të mundur të kemi disa ditë në javë edhe Inspektorin e Zyrës së punës pranë bashkisë Fushë-Arrëz. Shërbimet duhet të shkojnë te qytetarët dhe jo qytetarët te shërbimi.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Duke qenë se ju komisioni keni rënë dakord i propozojmë Këshillit të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Shkurt 2025.

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Shkurt 2025 përmes votimit:

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Shkurt 2025 **me:**

**9 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Pika numër 2 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

**Sokol Vata**, Përfaqësues i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave:

Kemi hartuar Planin e Masave për vitin 2025, duke u bazuar edhe në realitetin e vitit të kaluar. Kemi qenë bashkia më e mirë sa i përket angazhimit në raste të rënies së zjarrit.

Në kuadër të marrjes së masave për parandalimin e rënies së zjarrëve në pyje dhe kullota në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për vitin 2025 hartoi planin e masave paraprahe për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret në bashkëpunim me sektorin e Emergjencave Civile dhe M.Z.SH si më poshtë:

1. Organizimi i takimeve me banoret e të gjithë Njësive Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz për domosdoshmërinë e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret (Mars - Prill 2025).
2. Përpilimi dhe shpërndarja për çdo Njësi Administrative dhe fshat të formularëve të skuadrave të M.Z.SH-së, instruktimi i këtyre skuadrave të zjarrfikësve të fshatit (Mars-15 Maj 2025).
3. Organizimi i mbledhjeve nga Kryetarët e fshatrave me të gjithë banorët, krijimi i skuadrave zjarrfikëse dhe vrojtuesve ditorë të fshatrave (deri në 15 Prill 2025).
4. Krijimi i skuadrave zjarrfikëse, sjellja e listave me emrat e skuadrave pranë Seksionit të Pyjeve për secilin fshat (deri në 15 Maj 2025).
5. Evidentimi dhe mbajtja në vëzhgim të përhershëm të zonave të nxehta me rrezikshmëri të lartë për zjarre (Maj 2025 e në vazhdimësi).
6. Njoftimi në kohë të shpejtë i rënies së zjarrit dhe marrja në kohë e masave për izolimin e tij (gjatë gjithë kohës).
7. Përpilimi i dokumentacionit të nevojshëm për zjarret, dhënia e menjëhershme e informacioneve organeve përgjegjëse (vazhdimisht).
8. Për parandalimin e zjarrëve në pyje do të bashkëpunohet me të gjithë aktorët privat dhe shtetërorë që operojnë në Bashkinë e Fushë-Arrëzit (vazhdimisht).
9. Në çdo rast nevojë do të kërkohet edhe ndihma e të gjithë insuticioneve të Qendrave Shëndetësore dhe Arsimore që janë në territorin e Bashkisë (vazhdimisht).
10. Do të bashkëpunohet ngushtë me median lokale e kombëtare, vizive dhe të shkruar për ndërgjegjësimin e komunitetit për parandalimin e zjarreve në pyje (Korrik 2025).
11. Do të përdorim Togëfjalshin "MBRONI PYJET NGA ZJARRET" dhe "PYJET JANË PASURI E JONË" si mbishkrime në vende të dukshme për sensibilizimin e komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret.

Banorët po djegin mbeturinat në tokat e tyre dhe kjo përbën rrezik për përhapjen e zjarreve në pyje, ne jemi të gatshëm për ndërhyrje dhe ndërgjegjësim të banorëve për mbrojtjen dhe kujdesin për pyjet. Ne jemi vazhdimisht në kontakt me Administratorët e Njësive.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Të nderuar këshilltarë!

Sektori Pyjor është funksion i deleguar derisa të kaloj në funksionet e veta në kuptimin ligjor. Ky lloj prokti vjen këtu për tu parë nëse dikush nga ne kemi diçka për të shtuar sepse ky plan-projekt ka kaluar më parë në duart e specialistëve me përvojë.

Atëherë ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025, në territorin Administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi për planin e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025, në territorin administrativ të bashkisë Fushë-Arrëz **me**:

**9 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Pika numër 3 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz.

**Dritan Lika**, Përgjegjës i Zyrës së Financës:

Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, janë hartuar duke u bazuar në objektivat e zhvillimit të Bashkisë, të cilat lidhen me funksionet respektive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara në kuadrin ligjor në nivel programi, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë njësi. Dokumenti i PBA-së, prezanton qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program, duke u fokusuar në programet më prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

Ky projekt afatmesëm bazohet në vizionin tonë për Fushë-Arrëzin, i cili para së gjithash duhet të jetë një qytet lehtësisht i jetueshëm, me infrastrukturë moderne, me shërbime efikase dhe cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore e sportive të larmishme, me hapësira të gjelbërta të dedikuara për fëmijet dhe të moshuarit. Ne jemi të bindur se pavarësisht problemeve të shumta, qyteti i Fushë-Arrëzit, mbart një potencial të konsiderueshëm ekonomik, social e kulturor.

Objektivi themelor i këtij Programi Afatmesëm është përmirësimi në vazhdim i cilësisë së jetesës në Bashkinë e Fushë-Arrëzit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore, përmirësimit të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla, ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale, turizmit, etj.

Parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve është bazuar në:

1. Paketën fiskale të Bashkisë Fushë-Arrëz.
2. Shpërndarjen e burimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të qytetit.
3. Prioritetet e qytetarëve të evidentuara gjatë takimeve në çdo njësi administrative.

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i tavanëve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, janë :

- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit;
- Garantimi i pastërtisë së qytetit dhe i cilësisë së ajrit;
- Ofrimin e shërbimeve cilësore;
- Përmirësimin e infrastrukturës arsimore;
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, të cilat ndikojnë në shëndetin e popullatës;
- Gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet mbështetjes së projekteve;
- Mbështetja e turizmit.

Në çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet, duke përfshirë funksionet e veta dhe funksionet specifike, sipas llojit dhe njësive shpenzuese, ku përfshihen :

Shpenzimet, Programet Ekonomike, Tavanet e Shpenzimeve.

Sipas këtij materiali, të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, në mijë lekë, janë:

| <b>Përshkrimi</b>         | <b>2026</b>        | <b>2027</b>        | <b>2028</b>        |
|---------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Të ardhurat e veta        | 28,555,000         | 28,555,000         | 28,555,000         |
| Transferta e pakushtëzuar | 141,069,246        | 145,000,154        | 148,834,185        |
| Transferta specifike      | 125,429,703        | 125,429,703        | 125,429,703        |
| Transferta e kushtëzuar   | 108,034,000        | 108,034,000        | 108,034,000        |
| <b>Totali</b>             | <b>403,087,949</b> | <b>407,018,857</b> | <b>410,852,888</b> |

Përmes Tabelave në Monitor jepen detajet lidhur me:

Totalin e shpenzimeve për çdo Program;  
Planifikimin, Menaxhimin dhe Administrimin; Sigurine publike;  
Zhvillimin Ekonomik dhe Rural;  
Arsimin, Kulturën, Sportin, Çështjet Sociale; Punët Publike;  
Fondin Rezervë dhe Kontigjencë.

Si bazë për parashikimin e të ardhurave ka shërbyer vendimi i Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Fushë Arrëz, për vitin 2025", "Parashikimi i të ardhurave të Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025-2026" si dhe ndryshimet e reflektuara në "Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2026-2028".

Në funksion të të hyrave sipas tabelës së mësipërme Bashkia Fushë-Arrëz ka financuar të gjitha programet e sipër përmendura duke ruajtur dhe rritur nivelin e shërbimeve që ofron për qytetarët.

Tavanet e Shpenzimeve:

Ndryshe nga vitet e mëparshme, shpenzimet janë përshtatur sipas strukturës së re të programeve buxhetore. Si bazë për parashikimin e tavanëve të shpenzimeve ka shërbyer vendimi i Këshillit Bashkiak "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Fushë-Arrëz, për vitin 2025", duke ruajtur të njëjtin nivel të rritjes së shpenzimeve edhe për vitet në vazhdim sipas

udhëzimit. Shpenzimet administrative janë planifikuar me ulje nga viti në vit, kryesisht ato për administratën, ndërkohë që është planifikuar të jenë me rritje shpenzimet për shërbimet publike si: pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi rrugor, mirëmbajtja e rrugëve në qytet dhe në zonat rurale, mirëmbajtja e ambjenteve arsimore, shërbimet sociale, etj.

Përsa i takon shpenzimeve për personelin, për vitin 2026 është parashikuar të jenë në të njëjtat nivile me ato të parashkuara në vitin 2025, duke ruajtur të njëjtin trend për periudhën 2026-2028 është parashikuar të ruhet i njëjti nivel i pagave.

Investimet janë përqëndruar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht asaj rrugore dhe shërbimet publike, pa lënë mënjanë programet e tjera, duke synuar për një shtrirje të investimeve në të gjitha aspektet.

Totali i shpenzimeve të Bashkisë Fushë-Arrëz (korente dhe kapitale), në mijë lekë, për çdo program, bazuar në të ardhurat e veta dhe grantet ( i pakushtëzuar, specifik dhe i kushtëzuar), është si tabelat e shfaqura në ekran ku po ndiqet nga të gjithë.

Z. Lika thekson se ky dokument, hartimi i Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, për Bashkinë Fushë-Arrëz, është hartuar nga administrata e Bashkisë, nëpërmjet "Grupit për Menaxhimin Strategjik".

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Bashkisë Fushë-Arrëz me nevojat e qytetarëve dhe që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korente dhe kapitale për periudhën 2026-2028, duke prezantuar politikat financiare afatmesme të Bashkisë.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj këshilltarët të miratojmë Projektvendimin me Programin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz.

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi me Programin e Tavanëve të Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Fushë-Arrëz **me**:

**9 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 4 e rendit të ditës:** Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.

S'ka vendime të kthyera.

**Pika numër 5 e rendit të ditës:** Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Ka një kërkesë të ardhur nga Kryetari i fshatit Bugjon të Fierzës:

Të nderuar drejtues të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe anëtar të Këshillit Bashkiak, po ju drejtohem me këtë kërkesë për ndërhyrje. Ju bëjmë thirrje ju si Bashki, të merrni masa për hapjen e rrugës lidhëse Bugjon - Gralisht, e cila lidh fshatin Bugjon me Njesinë Administrative Fierzë dhe qytetin më të afërt të kësaj zone Bajram Curri. Kjo rrugë është e bllokuar që nga data 15/11/2024.

Kjo rrugë gjithashtu lidhë fshatrat Bugjon – Kokdodë – Berishë – Mertur – Iballe, pasi rruga e bjeshkës është tërësisht e amortizuar nga rënia e gurëve dhe gërryerjet e përrenjeve.

Mbetemi në pritje të marrjes në konsideratë të kërkesës tonë nga ana e juaj.

Kryetari i fshatit Bugjon, Anton Boqi.

**Anton Boqi**, Kryetar i fshatit Bugjon:

Ruga lidhëse në fjalë është e bllokuar që nga data 15.11.2024. Zona ka pak banorë por është e kufizuar nga shërbimet ushqimore, spitalore etj për arsye të bllokimit të lidhjes me qendrën. Kemi ngritur zërin si në Njësi si në Bashki por nuk ka ndryhuar gjendja. Ka ardhur Anton Doçi e ka parë njëherë i dërguar nga drejtuesi i bashkisë, por nuk e ka marrë përsipër për ndërhyrje sepse është terren i vështirë dhe rrezikohet jeta e fadromistit dhe njerëzve duke mos qenë e qëndrueshme. Edhe punonjësit e mirëmbajtjes duhet të jenë më eficient. Gjithsesi ne jemi në vështirësitë e bllokimit. Edhe mësuesit janë penguar të shkojnë te shkolla.

Nëse krihet rruga nga lart deri në bazë mundet të bëhet e qëndrueshme ndoshta.

Edhe me vijat vaditëse kemi problematika në Gralisht.

**Franc Doda**, anëtar këshilli:

Unë kam qenë vetë atje për shpërndarje ushqimesh dhe kam parë realitetin në vështirësi të bllokimit të asaj rruge, shpresojmë të gjendet një zgjidhje dhe rruga të zhblokohet në mënyrë që banorët e zonës të marrin shërbimet e nevojshme.

**Hil Curri**, Kryetar i bashkisë:

Për shtetin disa rrugë nuk ekzistojnë sepse nuk janë fare të regjistruara dhe një prej tyre është rruga në fjalë.

Banorët atje kanë të drejtë që ankohen, unë e kam ndjekur me shqetësim dhe kemi dërguar specialistë disa herë dhe e kanë verifikuar. Kjo rrugë nuk ka mbetur ashtu për lekë, por shkalla e vështirësisë është deri në atë pikë që rrezikohet jeta e manovratorëve apo e banorëve në një moment të mëvonshëm mbas hapjes sepse ingjinerët kanë rezultuar se ajo rrugë është e paqëndrueshme.

Do të bëjmë edhe një përpjekje duke dërguar atje një specialisht-mjeshtër të atij zanati që për momentin është edhe prezent këtu, Valentin Doçi.

Sa i përket vijave vaditëse do i hapim me punëtorët e shërbimit.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Unë ngul këmbë që rruga të kontrollohet me Ingjinerë, teknikë dhe specialistë dhe më mirë le të mos hapet aty ku është por të verifikohet nëse ka mundësi të devijohet gjurma e rrugës

dhe të garantohet siguria e njerëzve sesa të rrezikohet jeta e banorëve përmes shembjeve që mund të pësojë në momente të papritura.

Ne si këshill këshillojmë që të mos ketë ndërhyrje deri në datën që na ka kufizuar ligji në periudhën e fushatës zgjedhore, më pas jemi për zgjidhje të menjëhershme të mundur. Ne buxhetin e kemi të miratuar dhe kryetari është i gatshëm për zgjidhjen e problematikave të tilla si kjo brenda kornizës ligjore.

**Valentin Doçi**, anëtar këshilli ( specialist-mjeshtër- manovrator për hapjen e rrugëve):

Unë do shkoj Brenda 2-3 ditëve dhe do të bëj verifikimin edhe njëherë nëse është e mundur do e bëjmë.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 6 e rendit të ditës:** Të ndryshme.

**Valentin Doçi**, anëtar këshilli:

Kam një shqetësim lidhur ujin vaditës në lagjen tonë, Nushaj. Ky është problem i kahershëm nuk është i sotshëm, por tani që janë vendos matësit e ujit të pijshëm nuk kemi opsion zgjidhje.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ky shqetësim është i përsëritur ndër vite më parë. Vijat vaditëse nuk duhet të humbasin, zgjidhja mund të bëhet me tuba e mure mbajtëse në bashkëpunim me pronarët e hidrocentralit që kanë shkaktuar problematikën. Kjo nuk është e pazgjidhshme, janë hapur rrugë e ndërtime gjithandej por nuk janë cënuar të drejtat dhe shërbimet e banorëve.

Ne nuk duam të pengojmë HEC-in por duhet të mos pengojmë banorët në zhvillimin e rrjedhën e jetës së tyre.

**Hil Curri**, Kryetar i bashkisë:

Firma investitore që ka hidrocentralin në momentin fillestar duhej të nënshkruante një kontratë, kur ka marrë pëlqimin në këshill, gjë e cila nuk është bërë.

Unë kam bërë përpjekjet e mia dhe do vazhdoj t'i bëj me përfaqësuesit e hidrocentralit dhe nëse nuk binden do të detyrohem të marrim një vendim këshilli brenda gjithë kornizës ligjore.

**Besjana Marku**, anëtare e këshillit:

Ku jemi me problematikën e ujit të pijshëm?

**Hil Curri**, Kryetar i bashkisë:

Kemi nisë procedurën me shkresa të dërguara dhe hap pas hapi do ndjekim përcaktimet e mëparshme edhe në këshill me takimin e planifikuar.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

**SEKRETAR**

**Naze SELIMAJ**

**KRYETAR**

**Nikolin BARDHOKU**



Besiana Marku

Valentina Heshaj

Yllken

Franc Doda

Vjollza Tabakaj

Terez Denu Jenu

Valentin Doci

Mustaf Pashkaj